



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 538 / Prot

Datë 03 / 02. 2020

2

VENDIM

Nr. 02 , Datë 31 . 01 . 2020

“ PËR
MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË,
PËRJASHTIM/REDUKTIVIM TARIFE SHKOLLIMI, PËR VITIN 2019-2020 ”

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” të ndryshuar me VKM-së Nr. 40 datë 23.01.2019, nr. 779, datë 26.12.2018; VKM nr. 778, datë 26.12.2018 “ për një ndryshim dhe shtesë në VKM-në nr. 288, datë 21.05.2018, të këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve , në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë “, të ndryshuar; VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018 “ Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programme të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”; VKM-së nr. 784, datë 26.12.2018 “ Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fodi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer , studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, VKM-së Nr. 39 datë 23.01.2019, Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë bursë sipas pasqyrës nr.1 bashkëlidhur
2. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë (shtresave sociale në nevojë) që përfitojnë përjashtim në masën 100 % të tarifës sipas pasqyrës nr.2 bashkëlidhur.
3. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë (mesatare 9-10) që përfitojnë përjashtim në masën 100 % të tarifës sipas pasqyrës nr.3 bashkëlidhur.

4. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas pasqyrës nr.4 bashkëlidhur.
5. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të dytë me kohë të plotë (kategoritë sociale) që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas pasqyrës nr.5 bashkëlidhur.
6. Të miratojë listën emërore të studentëve të ciklit të dytë me kohë të plotë (mesatare 9-10) që përfitojnë reduktim në masën 50 % të tarifës sipas pasqyrës nr.6 bashkëlidhur.
7. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në buxhetin e vitit 2020.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij për vitin akademik 2019-2020.
9. Ky vendim t'i njoftohet AKFAL-it, MASR-së, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit të Tiranës për vitin 2020, sipas pasqyrës nr.7 bashkëlidhur.

